

INFORMACIONE MBI SHTETIN
TETOR 2022

Shqipëria



HYRJE

Indeksi i Pashtetësisë (<https://index.statelessness.eu/>) është një mjet krahasues online që vlerëson ligjin, politikën dhe praktikën e vendeve evropiane mbi mbrojtjen e personave pa shtetësi dhe parandalimin e reduktimit të pashtetësisë kundrejt normave ndërkombëtare dhe praktikave të mira. Indeksi është zhvilluar dhe mbajtur nga **Rrjeti Evropian për Pashtetësinë (ENS)**,¹ një aleancë e shoqërisë civile e mbi 170 organizatave dhe individëve në 41 vende që punojnë për t'i dhënë fund pashtetësisë dhe për të siguruar që njerëzit pa shtetësi në Evropë të kenë të drejtat e tyre.

ENS ka punuar me anëtarët e saj² për të hulumtuar dhe hartuar informacionin krahasues mbi pashtetësinë në **Shqipëri**.³ Ky informacion bën një përmbledhje të gjetjeve se si ligji, politika dhe praktika shqiptare funksionojnë kundrejt normave ndërkombëtare dhe praktikave të mira mbi mbrojtjen e personave pa shtetësi dhe parandalimin e reduktimit të pashtetësisë. Informacioni trajton pesë fusha tematike - Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale, të dhënat e popullsisë pa shtetësi, statusi dhe përcaktimi i pashtetësisë, paraburgimi e parandalimi dhe reduktimi - dhe i parashtron Qeverisë Shqiptare një sërë rekomandimesh për reforma në fushat prioritare.

Person pa shtetësi do të thotë një person i cili nuk konsiderohet shtetas i ndonjë shteti sipas veprimit të ligjit të tij. Është një anomali ligjore që pengon më shumë se 10 milion njerëz në të gjithë botën - dhe më shumë se gjysmë milioni në Evropë - të kenë qasje në të drejtat themelore civile, politike, ekonomike, kulturore dhe sociale.



INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE

Traktatet e ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale parashikojnë mbrojtjen e personave pa shtetësi dhe parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë.

Shqipëria është Shtet palë në tre nga konventat kryesore të pashtetësisë: **Konventa e vitit 1954 në Lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi**, **Konventa e vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë** dhe **Konventa Evropiane për Shtetësinë**. Shqipëria ka ratifikuar pa rezerva në këto traktate dhe të gjitha kanë efekt të drejtpërdrejtë në ligjin vendas. Gjithashtu, Shqipëria është Shtet palë pa rezerva në thuajse të gjitha instrumentet e tjera përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale, me përjashtim të **Konventës së Këshillit të Evropës për Shmangien e Pashtetësisë në lidhje me Suksedimin e Shteteve**.

Ekziston një përkufizim i termit person pa shtetësi në ligjin shqiptar, por aty thuhet se një person pa shtetësi është "një person që nuk është shtetas i asnjë shteti", përkufizim i cili është më i ngushtë sesa ai në Konventën e vitit 1954 që e specifikon 'sipas veprimit të ligjit të tij'.

Shqipëria duhet të marrë parasysh që ta përshtasë përkufizimin e një personi pa shtetësi sipas Konventës së vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi, si edhe të aderojë në Konventën e Këshillit të Evropës mbi Shmangien e Pashtetësisë në lidhje me Suksedimin e Shteteve.



TË DHËNAT E POPULLSISË PA SHTETËSI

Shtetet duhet të mbledhin të dhëna të besueshme sasiore dhe cilësore mbi pashtetësinë si edhe të sanksionojnë dhe forcojnë masat për të numëruar personat pa shtetësi në territorin e tyre.⁴ Disponueshmëria e të dhënave të besueshme lidhet me ekzistencën apo jo të procedurave mbi identifikimin dhe përcaktimin e pashtetësisë. Identifikimi i personave pa shtetësi mbetet hapi i parë për mbrojtjen e të drejtave të tyre, por gjithashtu çon në një kuptueshmëri më të qartë të sfidave që duhet të adresohen.

Janë të disponueshme disa të dhëna për popullsinë pa shtetësi në Shqipëri, megjithatë kjo është disi e kufizuar. Regjistrimi i fundit i popullsisë që u krye në 2011 përfshiu një kategori 'pa shtetësi' për të cilën disponohen të dhëna të ndara sipas gjinisë, por jo sipas statusit të vendbanimit apo dokumentacionit, dhe kjo tashmë nuk është e azhurnuar. Në vitin 2011, 7,443 persona pa shtetësi u identifikuan në procesin e regjistrimit (3,874 burra dhe 3,569 gra). Një studim hartëzimi i kryer nga UNHCR dhe Shërbimi Ligjor Falas Tiranë në 2018 identifikoi 1031 fëmijë dhe të rritur që janë në rrezik pashtetësie në Shqipëri.

Autoritetet e regjistrimit në gjendjen civile prezantuan një mjet për të përmirësuar identifikimin e personave në rrezik pashtetësie në 2018.

Nuk ka një kategori 'pa shtetësi' në të dhënat e azilit dhe imigracionit dhe nuk disponohet informacion për personat pa shtetësi që mbahen në paraburgimin e imigracionit.

Qeveria e Shqipërisë duhet të ndërmarrë hapa konkretë për të përmirësuar regjistrimin e pashtetësisë, përfshirë harmonizimin dhe ndarjen e të dhënave mbi personat pa shtetësi në Shqipëri dhe ngritjen e kapacitetit të nëpunësve për të identifikuar dhe regjistruar me saktësi pashtetësinë. Ajo duhet të marrë parasysh kryerjen e një ushtrimi gjithëpërfshirës për të bërë një hartëzim të saktë të popullsisë pa shtetësi në Shqipëri.



PËRCAKTIMI DHE STATUSI I PASHTETËSISË

Për të qenë në gjendje të ofrojnë mbrojtjen dhe të drejtat e përcaktuara në Konventën e vitit 1954, përfshi lejen e qëndrimit dhe të drejtën për punë, studim dhe natyralizim të lehtësuar, Shtetet palë duhet të jenë në gjendje të identifikojnë personat pa shtetësi në territorin e tyre. UNHCR rekomandon që kjo përbushet më së miri përmes një procedure të dedikuar për përcaktimin e pashtetësisë.⁵

Ligji shqiptar parashikon se procedura për aplikimin, vlerësimin, miratimin dhe refuzimin e kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Deri më tani udhëzimi i ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë nuk është miratuar. Nuk ka një trajnim formal të posaçëm të organeve qeveritare në lidhje me pashtetësinë.

Ekziston një rrugë më e lehtë për natyralizimin e personave pa shtetësi në Shqipëri, por qasja në të pengohet nga mungesa e një procedure të përcaktimit të pashtetësisë. Personat pa shtetësi mund të natyralizohen pas shtatë vitesh qëndrimi të ligjshëm në Shqipëri dhe përjashtohen nga disa kërkesa për natyralizim, si moshë minimale, të ardhurat dhe pronësia mbi pronën, kriteri për të mos qenë të dënuar më parë dhe testi i gjuhës. Nuk ka ndonjë përcaktim ligjor për një tarifë, por aplikantët paguajnë afërsisht 50 euro dhe personat pa shtetësi nuk përjashtohen nga kjo.

Ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike duhet të miratojë udhëzimin për përcaktimin e pashtetësisë në përputhje me praktikën e mira për të përbushur plotësisht të drejtat e parashikuara në Konventën e vitit 1954 dhe në ligjin shqiptar mbi personat pa shtetësi, përfshirë një rrugë më të lehtë për natyralizim. Qeveria e Shqipërisë gjithashtu duhet të sigurojë që personat pa shtetësi të kenë akses në gamën e plotë të të drejtave që mbrohen sipas Konventës së 1954.



NDALIMI

Personat pa shtetësi përballen me një rrezik të shtuar të ndalimit arbitrar, veçanërisht kur mungojnë masat mbrojtëse procedurale për identifikimin dhe përcaktimin e pashtetësisë dhe barrierave që lidhen me largimin.⁶

Ekzistojnë masa mbrojtëse të kufizuara për të parandaluar ndalimin arbitrar të personave pa shtetësi në Shqipëri. Duhet të identifikohet një vend largimi para lëshimit të urdhrat të dëbimit dhe vendimit të ndalimit,

megjithatë pashtetësia nuk identifikohet në mënyrë pro-aktive në vendimet e ndalimit dhe as në vlerësimet e vulnerabilitetit.

Nuk ka prova që personat pa shtetësi paraburgosen në mënyrë të shpeshtë, megjithatë duke pasur parasysh mungesën e një procedure në përcaktimin e pashtetësisë, është e mundur që të ketë raste të paraburgimit të personave pa shtetësi. Ligji lejon që të zbatohen masa alternative, por nuk është e domosdoshme që të ezaurohen të gjitha alternativat para ndalimit.

Ekzistojnë disa masa mbrojtëse të kufizuara procedurale, por ka pengesa në mjetet juridike efektive dhe pengesa në marrjen e ndihmës juridike. Personave të liruar nga ndalimi nuk u jepet asnjë dokument apo mbrojtje nga ri-ndalimi.

Qeveria e Shqipërisë duhet të krijojë mekanizma të fuqishëm për të identifikuar dhe mbrojtur personat pa shtetësi nga ndalimi arbitrar, përfshirë një mekanizëm referimi të një procedure për përcaktimin e pashtetësisë dhe të drejtat e qëndrimit për ata persona që lirohen nga paraburgimi në mënyrë që të mbrohen nga ri-ndalimi. Ajo gjithashtu duhet të përfshijë shqyrtimin e pashtetësisë si një fakt me vlerë juridike në të gjitha vendimet për ndalimin.



PARANDALIMI DHE REDUKTIMI

Si shtet palë në Konventën e vitit 1961 dhe Konventën Evropiane për Shtetësinë, Shqipëria ka detyrime për të parandaluar dhe reduktuar pashtetësinë në territorin e saj.

Ligji i ri për shtetësinë shqiptare i vitit 2020 u përfshin edhe një masë mbrojtëse që garanton që fëmijët e lindur në territorin në fjalë të cilët, në raste të tjera do të rezultojnë pa shtetësi, të marrin shtetësinë shqiptare, duke plotësuar kështu masën mbrojtëse që ekziston për të miturit e braktisur. Masa e re mbrojtëse është automatike, por mbetet të shihet se si do të zbatohet në praktikë. Masat mbrojtëse janë gjithashtu të vendosura për të parandaluar pashtetësinë që lind gjatë procedurave të birësimit. Fëmijët e lindur nga shtetas shqiptarë jashtë vendit marrin shtetësi, por është e paqartë se çfarë të drejtash do të kenë prindërit e së njëjtës gjini në dhënien e shtetësisë një fëmije.

Shqipëria është zotuar të adresojë boshllëqet e mbetura në kuadrin ligjor dhe ka ndërmarrë hapa kohët e fundit për të parandaluar dhe reduktuar rrezikun e pashtetësisë. Sidoqoftë, fëmijët ende mund të përballen me rrezikun e pashtetësisë nëse prindërit nuk disponojnë dokumente ose kanë parregullsi në dokumentacionin e tyre, veçanërisht nëse kanë lindur jashtë vendit. Ka prova se komunitetet romë dhe egjiptiane janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga ky rrezik.

Ekzistojnë dispozita për heqjen dhe lënien e shtetësisë që mund të çojnë në pashtetësi në disa raste. Dispozitat e reja për heqjen e shtetësisë u prezantuan në vitin 2020, ku gjithashtu u përfshinë kompetenca të reja për heqjen e shtetësisë së shqiptarëve të natyralizuar për motive të sigurisë kombëtare (jo në ato raste kur do të çonte në pashtetësi) dhe u hoq një masë mbrojtëse shtesë për të evituar pashtetësinë që lind nga heqja dorë e shtetësisë.

Qeveria Shqiptare duhet të zbatojë plotësisht Ligjin për Shtetësinë, i miratuar në vitin 2020, dhe duhet të garantojë që të gjithë fëmijët e lindur në territorin e saj, të cilët, në raste të tjera, do të rezultojnë pa shtetësi, të marrin automatikisht një shtetësi në lindje pa kushte.

Qeveria Shqiptare duhet të marrë masa mbrojtëse të mëtejshme për të parandaluar pashtetësinë që lind nga çdo lënie, humbje ose heqje e shtetësisë.

PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

Qeveria e Shqipërisë duhet:

- Të hartojë përkufizimin e një personi pa shtetësi në ligjin shqiptar në përputhje me Konventën e vitit 1954 mbi Statusin e Personave pa Shtetësi.
- Të marrë parasysh aderimin në Këshillin e Konventës Evropiane mbi Shmangien e Pashtetësisë në Lidhje me Suksedimin e Shteteve.
- Të marrë hapa konkretë për të përmirësuar regjistrimin e pashtetësisë, përfshirë harmonizimin dhe ndarjen e të dhënave për personat pa shtetësi në Shqipëri dhe ngritjen e kapacitetit të nëpunësve për të identifikuar dhe regjistruar me saktësi pashtetësinë.
- Të marrë parasysh kryerjen e një ushtrimi gjithëpërfshirës për të bërë hartëzimin e saktë të popullsisë pa shtetësi në Shqipëri.
- Të miratojë Udhëzimin për përcaktimin e pashtetësisë në përputhje me praktikën e mira për të përmbushur plotësisht të drejtat e parashikuara në Konventën e 1954 dhe në ligjin shqiptar për personat pa shtetësi, duke përfshirë edhe një rrugë më të lehtë për natyralizimin.
- Të vendosë mekanizma të fuqishëm për të identifikuar dhe mbrojtur personat pa shtetësi nga ndalimi arbitrar, duke përfshirë një mekanizëm referimi të një procedurë për përcaktimin e pashtetësisë dhe të drejtave të qëndrimit për ata që lirohen nga paraburgimi që të mund të mbrohen nga ri-ndalimi.
- Të përfshijë shqyrtimin e pashtetësisë si një fakt me vlerë juridike në të gjitha vendimet për ndalimin.
- Të zbatojë plotësisht Ligjin për Shtetësinë miratuar në vitin 2020, dhe të garantojë që të gjithë fëmijët e lindur në territorin e tij, të cilët, në raste të tjera do rezultojnë pa shtetësi, të marrin automatikisht një shtetësi në lindje pa kushte të tjera.
- Qeveria Shqiptare duhet të marrë masa mbrojtëse të mëtejshme për të parandaluar pashtetësinë që lind nga çdo lënie, humbje ose heqje e shtetësisë.

SHËNIME PËRMBYLLËSE

¹ <http://www.statelessness.eu/>

² Studiuësja Kryesore Lokale për Indeksin e Pashtetësisë në Shqipëri është Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS).

³ <https://index.statelessness.eu/country/albania>

⁴ Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Përfaqësuesve nga Qeveritë e Shteteve Anëtare mbi Pashtetësinë, 4 Dhjetor 2015, <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/12/04/council-adopts-conclusions-on-statelessness/>

⁵ UNHCR (2014), Manuali mbi Mbrojtjen e Personave Pa Shtetësi,

<http://www.unhcr.org/uk/protection/statelessness/53b698ab9/handbookprotection-stateless-persons.html>

⁶ ENS (2017) Mbrojtja e Personave pa Shtetësi nga Ndalimi Arbitrar: Një Axhendë për Ndryshim,

https://www.statelessness.eu/sites/www.statelessness.eu/files/attachments/resources/ENS_LockeInLimbo_Detention_Agenda_online.pdf

KONTAKT

Raimonda Bozo

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

rbozo@tlas.org.al

Nina Murray

Drejtoresha e Politikave dhe Kërkimit, Rrjeti Evropian për Pashtetësinë

nina.murray@statelessness.eu



European
Network on
Statelessness

London, United Kingdom
Media: +44 7522 525673
info@statelessness.eu
www.statelessness.eu



European
Network on
Statelessness

The European Network on Statelessness is a registered Charitable Incorporated Organisation in England. Charity Number 1158414.